




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTESISË

DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT  
SHOQËRIA PËRMBARIMORE « ENFORCEMENT GROUP» SHPK

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr.1, Pall, e Shoqërisë "GORA" Kati 3, Ap.14, Tirane / Cel.

0692087566

e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com



Nr. 1030/4 Prot.

Tiranë më, 25.10.2016

Nr. 1030 Regj.

**URDHËR  
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE  
MBI KUOTAT E DEBITORIT**

**Drejtuar :** Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. ✓  
**Adresa :** Tiranë.  
**Për dijeni:** Shoqërisë "Flora Ko" shpk me Nipt J61804014I.  
**Adresa:** Rruga e Qelqit, Kombinat, Tiranë.

Unë Altin Latifi, me detyrë Përmbarues Gjyqësor Privat pranë shoqërisë përmbarimore "Enforcement Group" shpk, pasi studiova materialet e dosjes me Nr. 1030 Regj, bazuar në Urdhrin e ekzekutimit Nr.1429/U datë 13.06.2016, i Gjykatës së Apelit Tiranë,

**K O N S T A T O V A**

Se në datë 10.11.2016, pranë shoqërisë përmbarimore "Enforcement Group" shpk, është depozituar për Ekzekutim, kërkesa e kreditorit Shoqëria Alba Ledi sha, së bashku me Titullin Ekzekutiv Vendimi Gjyqësor Nr.1429 datë 13.06.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka ndryshuar pjesërisht vendimin Nr.2805 datë 08.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin ka dalë Urdhri i Ekzekutimit Nr.1429/U datë 13.06.2016, i Gjykatës së Apelit Tiranë, me palë e objekt :

Kreditor: Shoqëria Alba Ledi sha  
Debitor: Shoqëria "Flora Ko" shpk me Nipt J61804014I  
Objekti: Pagim shume

**Me anë të këtij titulli ekzekutiv është vendosur :**

Detyrimi i palës së paditur Shoqëria "Flora Ko" shpk me Nipt J61804014I që ti paguajë palës paditëse detyrimin në bazë të titullit ekzekutiv.

**Për sa më sipër:**

Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

**URDHËROJ:**

- 1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative në kuotat e Shoqërisë "Flora Ko" shpk me Nipt J61804014I.
2. Kuotat e mësipërme do të qëndrojnë të sekuestruara deri në një urdhër të dytë nga ana e zyrës sonë përmbarimore.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin 606 te K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 te K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.
- 6.Pas dërgesës së këtij urdhri për vendosjen e sekuestros konservative mbi kuotat e debitorit të sipërcituar në shoqëritë e sipërcituara, kërkohet të na dërgohet pranë zyrës sonë statusi i kuotave pas kryerjes së bllokimit, brenda afatit ligjor.

SHOQERIA PERMBARIMORE "ENFORCEMENT GROUP" SHPK  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
ALTIN LATIFI

